

Përshëndetje,

lidhur me kërkesën tuaj, datë 08.03.2024 (bashkëlidhur), ju informojmë se:

Lista e Barnave të Rimbursuara në fuqi, e përditësuar, është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 05.04.2023, dhe ka filluar efektet nga data 01 maj 2023.

Së fundmi, nga Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, është miratuar LBR e përditësuar për vitin 2024, e cila pritet të hyjë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

Si rezultat i procesit të ndryshimit të çmimeve të barnave, është bërë përlogaritja e efektit ekonomik.

Lidhur me informacionin për çmimet e tregtimit të barnave të rimbursueshme, aktualisht në farmacitë spitalore dhe farmacitë e rrjetit të hapur farmaceutik, (të miratuara me VKM-në nr. 196, datë 05.04.2023), ju mund t'i gjeni të publikuara në webfaqen zyrtare të FSDKSH-së, në link-un <https://fsdksh.gov.al/project/lista-e-barnave/>. Ndërkohë që, çmimet e barnave të rimbursueshme në draft LBR-në e miratuar së fundmi nga Këshilli Administrativ i Fondit, hyjnë në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.